

# Fiskalizimi dhe Problematikat aktuale

Dhjetor 2021



**pwc**



## Operatorët në Portalin Self Care

- Mos-funksionim i portalit Self Care

Në rastet e mos funksionimit të portalit Self Care bëhet e pamundur deklarimi dhe regjistrimi i operatorëve të rinj për fiskalizimin e faturave.

Gjatë muajit Tetor 2021 ka pasur problematika në procesin e deklarimit të operatorëve.

- Procesi për regjistrimin e operatoreve zgjat 48 orë dhe jo 24 orë

Portali Self Care nuk i njeh punonjësit e deklaruar në tatime në momentin që bëhet deklarimi i tyre por nevojiten 24 orë që ID e punonjësit të shfaqet dhe të bëhet deklarimi si operator. Nevojiten edhe 24 orë të tjera nga momenti i deklarimit të punonjësit si operator në mënyrë që ai/ajo të jetë në gjendje për të fiskalizuar një faturë.

Kjo paraqet vonesa dhe kosto të shtuar për biznesin pasi një punonjësi i duhen 48 orë për kryerjen e aktiviteteve për të cilat ai është punësuar.

***Sugjerohet që deklarimi i një punonjësi si operator të mundësohet direkt në momentin e deklarimit të tij për fillim pune në e-tax.***

## ***Problemi aksesimit të Self Care nëpërmjet e-Albania***

- **Konfidencialiteti i të dhënave**

Aktualisht aksesimi i portalit Self Care është i mundur vetëm nëpërmjet përdorimit të kredencialeve në e-Albania të cilën subjekti e ka të celur tashmë. Në mungesë të userave specifike të cilët mund të përdoren nga punonjës në departamente të ndryshme të kompanisë (HR, Financa etj), e bën të domosdoshme dhënien e kredencialeve të e-Albania edhe tek punonjësit e përmendur më sipër.

Kjo përbën një problematikë pasi në portalin e-Albania janë të ruajtuara të dhëna konfidenciale për një kompani.

## ***Vonesë në shkarkimin e faturave nga self care***

- Harxhohet kohë me shkarkimin e faturave

Në momentin e shkarkimit të formatit të PDF-së së faturave të fiskalizuara të shitjeve dhe blerjeve (opsioni “Krijo PDF” në selfcare), shfaqet në mënyrë të vazhdueshme error-i “Kontaktimi administratorin”. Në disa raste është e nevojshme të përdoret 3-4 herë komanda në mënyrë që të shkarkohet fatura në formatin PDF.

***Sugjerohet që të shtohet një opsion që të bëhet shkarkimi i faturave me periudhë (psh. faturat nga dt....në dt...).***

## ***Problematika në aksesimin e portalit Self Care (ngadalësia)***

- Self Care i ngadaltë

Nisur nga volumi i subjekteve të cilat aksesojnë këtë platformë aktualisht, gjatë orëve normale të punës nga ngarkesa e tepërt portali nuk është i aksesueshëm.

## ***Problematikat që lidhen me faturat në librat e blerjes dhe të shitjes***

- Faturat e fiskalizuara nuk shfaqen në kohë reale në Self Care

Një pjesë e faturave shfaqen në seksion e E-invoice por nuk pasqyrohen në transaksionet e blerjes apo në pasqyrën mujore. Këto fatura në disa raste nuk rezultojnë në përmbledhësen mujore (artikulli librit të blerjes) dhe në disa raste shfaqen pas 2-3 ditësh.

- Mungesa e informacionit se cilës periudhë i përket fatura

Në transaksionet e blerjes, apo edhe në seksionin E-invoice nuk pasqyrohet se në cilën periudhë është përfshirë një faturë e caktuar duke bërë që ky informacion të sigurohet vetëm duke kontrolluar periudhat përkatëse të TVSH-së në pasqyrën mujore.

- Fatura blerje me vlera jo të sakta

Ka raste kur faturat shfaqen në rregull me vlerën përkatëse në seksionin e Transaksioneve të Blerjes, por ndërkohë në librin e blerjes këto fatura kanë vlerën 0 (zero).

## ***Problematikat që lidhen me faturat në librat e blerjes dhe të shitjes (vazhdim)***

- Shfaqja e faturave të cilat nuk i takojnë subjektit

Në Self Care shfaqen edhe fatura të cilat janë lëshuar gabimisht nga subjekte të tjera që kryejnë veprimtari tregtare. Këto kompani kanë vendosur emrin e një subjekti të caktuar por NIPT-in e një shoqërie tjetër gabimisht. Kjo përbën problematikë pasi në rastin e faturave të cilat janë CASH është e pamundur refuzimi i tyre në Self Care.

***Sugjerohet që platforma të bëjë kontroll të dyfishtë NIPT + emër subjekti.***

- Faturat e blerjes me përshkrimin “Sipas Situacionit bashkëngjitur”

Platforma qendrore e faturave nuk e ka të parashikuar opsionin për të bashkëngjitur informacione të tjera faturës duke e bërë të pamundur identifikimin e saktë.

Spektori i ndertimit konsiderohet me informalitet të lartë dhe gjykojme që është e nevojshme të formalizohet edhe situacioni i punimeve.

***Sugjerohet që faturat me situacione të kenë opsionin që zgjidhet që në fillim që ka situacion dhe të jetë e detyrueshme të bashkëngjitet situacioni në mënyrë që të fiskalizohet fatura.***

- Faturat e pafiskalizuara nga Institucionet Shtetërore

Aktualisht faturat që lëshohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (OSHEE Energji Elektrike), si dhe nga disa institucione të tjera publike janë sipas formatit të vjetër dhe të pafiskalizuara.

## ***Problematikat që lidhen me faturat në librat e blerjes dhe të shitjes (vazhdim)***

- **Dublikimi i një fature blerjeje në Self Care**

Ndodh shpesh që një faturë shitjeje e cila rezulton të jetë fiskalizuar vetëm një herë në Self Care dhe në software-in e shitësit, shfaqet sikur është fiskalizuar disa herë në Self Care të blerësit (Faturat kanë numër të njëjtë, por NIVF të ndryshme).

Duke qenë se kjo faturë pasqyrohet vetëm njëherë në portalin e shitësit e bën të pamundur edhe anulimin e saj.

- **Dublikim i Autongarkesave dhe Vetëfaturimeve**

Këto lloje faturash ka raste që shfaqen në Transaksionet e Blerjes dhe të Shitjes (si dhe në librat e blerjes dhe të shitjes) duke pasur replikim të NIVF.

## ***Problematikat që lidhen me faturat në librat e blerjes dhe të shitjes (vazhdim)***

- Përmbledhëse ditore vetëm në nivel kompanie

Aktualisht shitjet në librin e shitjes dhe në përmbledhëse afishohen në nivel kompanie dhe nuk është e mundur të gjenerohet një raport në bazë të NIPT-eve sekondare të cilat janë të celura edhe në Business Unit të ndryshëm.

***Sugjerohet që Self Care të gjenerojë dhe një përmbledhëse ditore në nivel NIPT sekondar (vendi ushtrimi te aktivitetit).***

- Eksportimi i transaksioneve të shitjes në Excel është i kufizuar

Aktualisht duke u bazuar në numrin e faturave të shitjes të cilat një subjekt lëshon, është e pamundur eksportimi i tyre për më shumë se 3-5 ditë (ato që kanë me qindra fatura shitje në ditë).

Gjithashtu, formati që eksportohet në excel nuk të jep mundësinë për të kryer veprime (të mbledhësh totalin e TVSH-së, vlerës së tatueshme etj).

- Shfaqja në Librin e Blerjes të faturave të refuzuara

Në librin e blerjes shfaqen fatura të cilat janë refuzuar nga subjekti në Self Care dhe kanë të azhornuar statusin e tyre në “Refuzuar”.

Sipas Udhëzimit nr.16, datë 03.04.2020, këto fatura në momentin që refuzohen nga blerësi nuk duhet të shfaqen në librat e blerjes të muajit përkatës.



## ***Problematikat që lidhen me faturat në librat e blerjes dhe të shitjes (vazhdim)***

- Mos shfaqja e vlerave në Lekë në faturat në monedhë të huaj

Për e-invoice të cilat janë në monedhe të ndryshme nga ajo në Lekë aktualisht totali i faturës shfaqet vetëm në monedhen e huaj me përjashtim të vlerës totale të TVSH-se e cila afishohet edhe në Lekë sipas kursit të faturës.

Sipas kërkesave të ligjit (neni 6) është e nevojshme që totali i faturës të afishohet edhe në monedhën vendase si për vlerën e tatueshme ashtu edhe për vlerën që përfshin TVSH-në.

## ***Problematikat me fiskalizimin e Fletëve Doganore dhe Eksportet***

### ▪ Fiskalizimi i FD në Self Care

- Fiskalizimi i fletëve doganore është i pamundur për një pjesë të madhe të subjekteve të cilat kryejnë importe në mënyrë të vazhdueshme dhe deklaratat e të cilëve kanë një numër të konsiderueshëm artikujsh.

- Në disa raste nuk shfaqen të gjitha deklaratat.

- Për shoqëritë të cilat operojnë si supermarket të cilat mund të kenë gamë produktesh që shkon deri në 12,000 kode artikujsh, fiskalizimi i fletëve doganore është i pamundur teknikisht pasi limit aktual është deri në 1000 rreshta.

***Sugjerohet që fletët doganore të mos kenë proces fiskalizimi dhe të jepet mundësia vetëm për shtimin e informacionit që lidhet me furnitorin e huaj në librin e blerjes.***

### ▪ Referenca Doganore në faturat e shtijes për eksport

Në disa raste Self Care nuk të ofron mundësinë që një fature shitje eksporti t'i vendosësh Referencën Doganore (psh. një fature e fiskalizuar në datë 1 Nëntor dhe për të cilën kanë kaluar 10 ditë por është brenda afatit për dorëzimin e librave).

### ▪ Fiskalizimi i Faturave të Shitjes për eksport me shumë artikuj

Edhe në rastin e faturave të shitjes për eksport të cilat kanë numër të konsiderueshëm artikujsh dhe që kalojnë limitin prej 150,000B, detyrohet shoqëria që të ndajë furnizimin në disa fatura shitje.

## ***Problematikat me fiskalizimin e Faturave Shoqëruese***

- Fiskalizimi i faturave shoqëruese me shumë artikuj

Për subjektet të cilat kanë disa magazina dhe përdorin faturat shoqëruese për lëvizjen e produkteve nga një magazinë në tjetrën shfaqet problem në momentin e fiskalizimit të faturave që janë më shumë se 150,000B (1,000 rreshta por bazohet edhe në numrin e karaktereve).

Si rezultat, shoqëritë detyrohen që një levizje malli ta ndajnë në disa fatura të tilla. Kjo nuk është e rregullt, gjithashtu shkakton dhe vonesa.

## ***Problematika me regjistrimin e arkës dhe gjenerimi i kodit TCR***

- **Regjistrimi i gabuar i Arkës**

Në momentin që Arka është celur njëherë dhe punonjësi në vend të klikoj “Shtim monedhash” klikon gabimisht përsëri “Celje”, në këtë rast veprimi dytë nuk fiskalizohet dhe në sistem nuk shfaqet asnjë error që të paralajmëroj për gabimin.

***Sugjerohet që të shtohet një pop-up për të njoftuar që është deklaruar njëherë celja për këtë ditë.***

- **Gjenerimi kodi TCR**

Në platformën qendrore të faturave shpesh ndodh që për arkëtarët/kasierët të mos gjenerohet kodi TCR.

## ***Problematika të tjera që lidhen me fiskalizimin***

- Shfaqja e të dhënave personale të operatorit dhe vendit të ushtrimit të veprimtarisë

Në e-invoice dalin të dhënat personale të operatorit dhe vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit. Shfaqja e këtyre të dhënave është në kundërshtim me ruajtjen e të dhënave personale dhe kërkesave të ligjit të fiskalizimit.

- Pamundësia për përdorimin e Self Care nga personat fizikë që plotësojnë kushtet

Subjektet të tilla e kanë të pamundur lëshimin e faturave në momentin që shitja është për një subjekt të huaj.

Referuar publikimeve në faqen zyrtare të tatimeve dhe udhëzimeve për këtë çështje, lloji i subjektit ndaj të cilit lëshohet një faturë (vendas apo i huaj) nuk është kusht për përdorimin e portalit për fiskalizimin e një fature.

- Pagesa e disa faturave njëkohësisht

Në bankë (online apo edhe në degë) duhet të bëhet pagesa vetëm e një fature elektronike duke vendosur NIVF.

Kjo rrit koston për biznesin pasi komisionet llogariten për numër faturash të paguara si dhe kohën e shpenzuar nga stafi.

## ***Koha e kufizuar për fiskalizimin e fletëve doganore dhe parapagimeve***

- Afat i shkurtër për fiskalizimin e parapagimeve dhe fletëve doganore.

Sipas ligjit:

- fiskalizimi i paragimit duhet të kryhet brenda 72 orëve nga marrja e tij.
- Fiskalizimi i fletëve doganore duhet të kryehet brenda 72 orëve nga dalja e mallit në qarkullim të lirë.

Për shoqëritë të cilat kryejnë importe në mënyrë të vazhdueshme është e pamundur plotësimi i këtij afati. Gjithashtu, edhe për parapagimet e marra në bankë rritet volumi i punës dhe koha e harxhuar.

***Sugjerohet që për parapagimet dhe fletët doganore të shtyhet afati për fiskalizimin e tyre psh. a) deri në fund të muajit ose b) brenda dates 10 të muajit pasardhës për të cilin bëhen deklaratimet, njësoj si për autofaturat.***

## ***Akti normativ në fuqi deri në 31 Dhjetor 2021***

- Shtyrja e afatit të Aktit normativ

Nisur nga problematikat e shumta që ka aktualisht procesi i fiskalizimit është e nevojshme që për subjektet të shtyhet afati për gjenerimin e gjobave deri më **30 Qershor 2022**.

Gjithashtu ky afat gjykohet i nevojshëm edhe për shtyrjen e afatit për dorëzimin automatik të librave të blerjes dhe shitjes.

# Draft-ligjet Dhjetor 2021



**pwc**





## **1 - Propozimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 ‘Për Taksat Kombëtare’, i ndryshuar”**

Në nenin 3, “Llojet e taksave kombëtare” dhe në nenin 4, “Niveli i taksave kombëtare” shtohen pikat:

**12.**Taksë për qumështin pluhur për tregti, në vlerën 100 lekë për kg.

**13.**Taksë për pijen e homogjenizuar barista në vlerën 16 lekë për litër.

**14.**Taksë për hurrë qumështi në vlerën 150 lekë për kg.

**15.**Taksë për krem qumështi në vlerën 150 lekë për litër.

**16.**Taksë për karburantin në zonat e lira doganore dhe magazinat doganore që përdoret për furnizimin e mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, në vlerën 65 lekë/litër.

Fabrikat e prodhimit me etiketë të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit përjashtohen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hurrë qumështi dhe taksës për krem qumështi.

## 2 - Propozimi i projektligjit “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për TVSH’, i ndryshuar”

- Në nenin 49 “Shkallët e reduktuara”, shtohet pika 10:

**10.** Shkalla e reduktuar e TVSH, e cila aplikohet për furnizimin e inputeve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuar në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, është 10%.

Këto inpute nuk i përkasin më normës së TVSH-së zero (Lista e mallrave të përjashtuara nga TVSH-ja në nenin 51).

- Në nenin 56 “Përjashtime të veçanta në import”:

Importimi i makinerive dhe pajisjeve në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë (nga 50 milionë lekë që ishte më parë) bën përjashtim të veçantë.

Gjithashtu, importimi i makinerive prodhuese nga subjektet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin shfuqizohet nga lista e përjashtimeve të veçanta në import.

- Në nenin 148 “Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor”, vlera e normës së kompensimit të prodhuesit bujqësor nga 6% bëhet 0%.

### 3- Propozimi i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar”.

Tatimi mbi te ardhurat personale propozohet si me poshte:

E ardhura nga paga në lekë/muaj		E ardhura e tatueshme në lekë/muaj		Norma Tatimore në përqindje/mujore
Nga	Deri në	Nga	Deri në	
0	40 000	0	40 000	0%
40 001	50 000	0	30 000	0%
		30 001	50 000	50% * 13% të shumës mbi 30 000 lekë
50 001	Më tepër	0	30 000	0%
		30 001	200 000	13% e shumës mbi 30 000 lekë
		200 001	Më tepër	22 100 lekë + 23% të shumës mbi 200 000 lekë

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare dhe i shtrin efektet duke filluar nga **data 1 korrik 2022**.

## 4 - Propozimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”

- Akciza e llogaritur në njësinë matëse sipas seksioneve respektive, indeksohet çdo dy vjet bazuar në normën e shpallur të inflacionit për dy vitet paraardhëse, me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve të tij. Në vitin 2022, akciza indeksohet me normën e shpallur të inflacionit të vitit 2020 plus normën e rezultuar të shpallur të inflacionit deri në fund të 9 mujorit të vitit 2021.
- Për mbikqyrjen e procesit të vendosjes së pullave, operatorë e autorizuar duhet të marrin masa për të siguruar
  - mbikqyrje me kamera
  - paraqitje e rakordimeve për çdo proces pullosje, si dhe
  - njoftimit paraprak 3 ditë përpara zhvillimit të procesit.

Autoriteti doganor kompetent mund të sigurojë prezencën e tij për mbikëqyrje.

- Tepricat ose mangësitë në pulla fiskale, të konstatuara gjatë kontrollit të magazinave fiskale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë nga 20.000 lekë deri në 50.000 lekë.
- Shkelja e detyrimit për mbajtjen e regjistrave, të kontabilitetit dhe diferencat ose mosdhënia e regjistrimeve, sipas kërkesës së organeve doganore, dënohet me gjobë në masën 50,000 lekë (më parë 500.000 lekë).

## **4 - Propozimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar” - vazhdim**

- Tepricat ose mangësitë në pullat fiskale

Per terpricat ose mangesite mbi 2% të sasisë kontabël të llogaritur të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomikë të cilët nuk janë depozitues të miratuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë sipas Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

#### **4 - Propozimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar” (vazhdim)**

Vendimi i autoriteteve doganore kompetente për pagimin e detyrimit të akcizës dhe/ose të sanksioneve përkatëse, të përcaktuara në këtë ligj, duhet të merret brenda 60 ditëve (ndryshuar nga 10 ditë që ishte më pare) nga data e njoftimit me shkrim të procesverbalit të konstatimit të shkeljes.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankesës (nga 30 ditë që ishte më pare) dhe ky vendim u njoftohet menjëherë apeluesit dhe autoriteteve doganore kompetente.

Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, apeluesi mund të ankohet pranë autoriteteve gjyqësore brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të mospranimit të ankesës (nga 30 ditë që ishte më pare), ose brenda 45 ditëve nga mbarimi i afatit të shqyrtimit të ankimit.

#### **5 - Ratifikimi i konventës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së shtetit të Izraelit, për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat.**

Ky projektligj është në shqyrtim për t’u aprovuar dhe synon të ratifikojë konventën ndërmjet dy shteteve, për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal.

Pas ratifikimit nga Kuvendi, kjo Marreveshje, hyn në fuqi dhe ka efekt nga 1 janari i vitit pasardhës, sic parashikohet në nenin 28 të Marreveshjes.

## 6 - Propozimi i projektligjit “Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, ‘Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit’, i ndryshuar”

- **Në Nenin 3** “Subjektet që i nënshtrohen këtij ligji” shtohen subjektet si vijon:
  - Secili individ, person fizik apo juridik, që tregton mallra apo shërbime në masën që kryen apo pranon pagesa në para fizike në një shumë prej 1,000,000 (një milion) lekësh ose më shumë.
  - Audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar, këshilltarët tatimorë, si dhe çdo person tjetër që merr përsipër të ofrojë ndihmë materiale, asistencë apo këshillim për çështje tatimore, si biznes kryesor apo veprimtari profesionale.”
  - Rasti kur agjentët e pasurive të paluajtshme veprojnë si ndërmjetës në dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, në lidhje me transaksionet për të cilat qiraja mujore arrin në vlerën e barabartë apo më të madhe se 500, 000 (pesëqind mijë) lekë.

## 6 - Propozimi i projektligjit “Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, ‘Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit’, i ndryshuar” - vazhdim

Të dhënat, informacioni dhe dokumentacioni i mbledhur në zbatim të ligjit ruhen për një periudhë 5-vjeçare nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit, por jo më shumë se 40 (dyzet) vite nga data e secilit transaksion apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo kryerjes së analizës.

- DPPP mund të refuzojë shkëmbimin e informacionit:

me agjencitë homologe të huaja kur shkëmbimi vlerësohet se është në kundërshtim me parimet themelore të legjislacionit shqiptar.

me subjekte të tjera kur dhënia e informacionit cenon një hetim të nisur, ose është qartazi jo në proporcion me interesat e ligjshme të një personi apo pa lidhje me qëllimin për të cilin është bërë kërkesa.”

- Organet ligjzbatuese informojnë DPPP për përdorimin e informacionit apo të dhënave, si dhe për rezultatet e hetimeve apo të inspektimeve të bazuara, në mënyrë periodike çdo 6 muaj.
- Avokatët përjashtohen nga detyrimi për raportim, për të dhënat që i kanë mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tyre, në një proces gjyqësor, ose nga dokumentet, që ky i fundit ua ka vënë në dispozicion, në funksion të mbrojtjes së kërkuar.



## **6 - Propozimi i projektligjit “Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, ‘Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit’, i ndryshuar” - vazhdim**

### ▪ Penalitetet

- Për rastet kur shkeljet janë të rënda, të përsëritura, apo sistematike, ndaj subjekteve vendoset gjoba maksimale në së paku 2-fishin e shumës së përfitimit të nxjerrë nga shkelja (kur ai përfitim mund të përcaktohet) ose deri në 125,000,000 lekë në rastet kur nuk mund të përcaktohet apo është më i vogël.

- Kur subjekti është person juridik, vendoset gjobë deri në 10% e qarkullimit total vjetor sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit të fundit. Në rast se 10% i qarkullimit total vjetor është më pak se 625,000,000 lekë, nga autoriteti përgjegjës vendoset gjoba deri në 625,000,000 lekë.

- Kur subjekti është person fizik vendoset gjoba deri në 625.000.000 lekë.



# Faleminderit!

PricewaterhouseCoopers Albania  
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: [al\\_pwc\\_albania@pwc.com](mailto:al_pwc_albania@pwc.com)

Web: [www.pwc.com/al](http://www.pwc.com/al)

